



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 8.12.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliqeviq.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Fjolla Uka- KDI.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.05/L-63 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar i plotësuar me ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116 dhe nr.04/L-194;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237;

5. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore në Projektligjin nr.05/L-41, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016;

Kryesuesja: Ju ftoj që të merrni fjalën lidhur me komentet që mund të keni për Projektligjin për Buxhetin sepse unë personalisht jam konsultuar me përfaqësuesit e subjektit tim, që janë në atë komision dhe nuk kam ndonjë vërejtje konkrete.

Nëse nuk keni ndonjë vërejtje, a jeni që amendamentet t'i miratojmë në pako, meqenëse amendamentet nuk janë kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës?

Milena Miliçević, tha se heq dorë nga votimi, pra abstenon sepse, pas konsultimeve që ka bërë me kolegen e saj e cila ishte e pranishme në Komisionin për Buxhet dhe Financa, tha se nuk jemi të kënaqur me kodimin që i është bërë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Kjo dhe është arsyeja pse abstenoj.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni me 7 vota **për** dhe 1 **abstenim**, vendosi që Komisionit Funksional dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

Rekomandim

1. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
3. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-063, për ndryshim plotësimin e ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr.03/L-221,nr.04/L-194:**

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-063, për ndryshimin e ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-194 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit Funksional dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-063 për ndryshimin e ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr.03/L-221,nr.04/L-194 amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;
4. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-042, për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237;**

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-042, për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Armend Zemaj: Personalisht jam kundër këtyre ndryshimeve që janë bërë për arsye se duhet të theksojmë se nuk ka analizim të qartë të marrjes së përgjegjësi sipas marrëveshjes së ratifikuar të MSA-së, sidomos tek çështja e mallrave dhe favorizimi i prodhimit të produkteve vendore. Sa i përket bordit të KRPP-së, tek emërimi i anëtarëve dhe mandati i tyre, unë mendoj që duhet të krijojmë standard që mund të jetë edhe rekomandim i komisionit. Ne dje e patëm një ndryshim ku nuk lejuam të ketë dy mandate nga 5 vjet por një mandat. Duke parë edhe natyrën dhe specifikat që ka Prokurimi Publik në Kosovë, mendoj që një mandat prej 5 vitesh është i kënaqshëm dhe besoj që njëjtë nuk do të ishte mirë dhe për vetë institucionin që të riemërohen. Kështu që, është vërejtje imja parimore që të kemi vetëm një mandat dhe jo të drejtë riemërimi në të njëjtin pozicion. Mund të bisedohet në seancë plenare apo në grupet politike. Kemi pas edhe me parë vërejtje të tilla, qoftë për individë të caktuar apo të institucioneve, në veçanti gjatë trajtimit të raportit të punës dhe ato të auditorit por edhe dyshimet që kanë dalë për hetime nga organet ndjekjes sepse 10 (dhjetë) vjet në një institucion i cili është shumë i ndjeshëm që ka të bëjë me rregullativën e Prokurimit Publik e që dyshimi më i madh është për afera korruptive. Besoj që nuk do të kontribuonte as institucionit por as edhe vendit në përgjithësi.

Nezir Çoçaj: Pajtohem me Armendin se qasja është shumë pozitive dhe sidomos në këto institucione ku ka ndikim që mund të ketë dyshime për korrupsion, personat që kanë afat të gjatë në një pozicion pune, është mirë të jenë sa më shkurt, në mënyrë që mos të bien ndesh me Kushtetutën dhe Ligjet. Duhet të ndryshojnë ligjet, në mënyrë që afati i qëndrimit në ato pozicione të jetë më i shkurtër dhe mundësisht të jetë 3 (tri) vjet dhe jo më tepër pa mundësi përsëritjeje.

Selvije Halimi, kryesuese: Ne realisht kemi aq shumë institucione që udhëhiqen nga bordet dhe pothuajse në të gjitha dominon mundësia e rizgjedhjes dhe për një afat dhe ajo rizgjedhje kryesisht bëhet përmes institucionit të Kuvendit. Unë në parim e mbështes plotësisht propozimin që në të gjitha institucionet publike ku me ligj janë të obliguar që të funksionojnë në bazë të një bordi qofshin ato borde që aprovohen nga Kuvendi, Qeveria apo

ato që mund të zgjidhen në bazë të cilitdo ligj dhe e kanë të caktuar mandatin dhe rizgjedhjen në mandate të njëjta. Unë pajtohen me idenë që në të gjitha bordet të kenë të drejtë vetëm një mandat, me të vetmin qëllim që të pamundësohet, ai familjarizimi i skajshëm me institucionin, ku personi zgjedhet në bord që mund të keqpërdoret nga cilido.

KRPP-ja dhe OSHP-ja janë aq të ndjeshme, sa vetë KPK-ja dhe KGJK-ja në një sferë tjetër, kështu që në këtë fazë ne mund të dërgojmë rekomandim me arsyetim apo mund ta aprovojmë si të tillë dhe në seancë me propozimin e njërit anëtar, komplet të gjithë anëtarët e komisionit kanë të drejtë por, edhe vetë deputetët mund ta pranojnë si ide dhe aty për aty mund të hyjë amendamenti. Të gjithë në vetvete po pajtoheni që të jetë vetëm një mandat, pa mundësi rizgjedhjeje.

Armend Zemaj: Të vendosim një standard sipas praktikave më të mira ndërkombëtare pa krijuar precedent për të gjitha institucionet me një mandat 5 vjeçar, duke shkuar me rekomandim për seancë plenare.

Doruntinë Maloku: Nëse insistohet të ketë të drejtë rizgjedhje të një anëtari të bordit, duhet të shkurtohet mandati sepse 5 +5, pra 10 vjet është shumë dhe anëtarët e bordit në këtë mënyrë krijojnë një lloj monopoli.

Agim Aliu: Padyshim që ky është projektligji më i rëndësishëm. Mendoj se është bërë një analogji e mirë edhe me projektligjet tjera që ne i kemi shqyrtuar, por fatkeqësi është që ne nuk jemi komisioni funksional për t'i dhënë ngjyrë apo përmbajtje këtij projektligji. Përderisa ne nuk e bëjmë një projektligj të mirë të Prokurimit Publik, mendoj se nuk i kemi punët mirë mes hierarkisë dhe perceptimit publik. Përkundër faktit që është perceptim, mendoj që është i drejtë sepse është sekret publik, për disa gjëra që zhvillohen në këtë fushë. Mund të shkojmë edhe me dy rekomandime, që të paktën të përfillet njëra prej tyre ose të shkojmë me mandat 3 (tre) vjeçar me mundësi vazhdimi ose vetëm me një mandat 5 (pesë) vjeçar, që për mua kjo e dyta është më mirë. Të bëhet një lloj standardi që sa herë të vijë një projektligj i ardhëm për cilindo institucion të kemi kujdesin e shtuar që mos të na kalojnë asnjëri nga këto institucione pa e vënë theksin në këtë çështje.

Unë jam dakord që të propozojmë në qoftë se dakordohemi, qoftë një rekomandim apo dy rekomandime Komisionit Funksional për këtë projektligj por, nëse nuk kalon në Komisionin Funksional, në seancë plenare e propozoni ju si kryesuese rekomandimin e këtij komisioni. Të përcaktohem cili propozim të shkojë si rekomandim, propozimi i parë apo i dytë?

Kryesuesja: Janë dy propozime; e para me mandat 5 (pesë) vjeçar, pa mundësi riemërimi dhe propozimi i dytë prej Doruntinës është që anëtarët e KRPP-ës të emërohen në të njëjtën kohë për një mandat 3 (tre) vjeçar me mundësi të riemërimit.

Doruntinë Maloku: Unë e kam një propozim që brenda një rekomandimi të shkojnë këto dy ide me këtë formulim "Mandati i anëtarëve të bordit të KRPP-ës duhet të jetë 5 (pesë) vjeçar ose 3 (tre) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes". Të dyja këto propozime të inkorporohen në një rekomandim dhe pastaj cilado që të përkrahet.

Kryesuesja: A jeni dakord që të bëjmë rekomandimin ashtu si aprovohet një raport me amendamente dhe ta kemi një rekomandim shtesë për amendamentin numër 13 për seancë?

A jeni për, që ta dërgojmë raportin me rekomandime si duhet dhe ta përgatisim një rekomandim jashtë atij që ta kemi ne si anëtarë të komisionit? Secili prej nesh e ka obligim

në grupet parlamentare ta diskutojë para seancës dhe pastaj në seancë dalim para deputetëve.

Kryesuesja konstatoi se komisioni me shumicë votash vendosi që Komisionit Funksional dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237 dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Rekomandohet që amendamenti 13, fjalët “1. Anëtarët e KRPP-së emërohen në të njëjtën kohë për një mandat prej 5 (pesë) vjetësh dhe mund të riemërohen vetëm një herë”, të hiqen dhe të zëvendësohen me fjalët “ Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi”;
3. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
5. **Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore në Projektligjin nr.05/L-41, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;**

Kryesuesja: Sipas materialeve ne nuk kemi komente nga komisionet tjera rreth këtyre amendamenteve, edhe pse sipas informimit të anëtarëve të PDK-së që janë komision për integritet ka pasur një presion të tmerrshëm nga përfaqësuesit e grupit për studime juridike dhe politike që të mos e aprovojnë raportin me amendamente sepse nuk janë marrë parasysht amendamentet e tyre. Unë i kam njoftuar ata që ne s'kemi mundur të ndërhyjmë në ligj bazik por, vetëm në pjesën e ndryshimeve që janë propozuar nga Qeveria dhe amendamentet janë më të mira dhe avancojnë ligjin në kuptimin e konfliktit të interesit në raport me ligjin aktual që është në fuqi.

Po ashtu, i kam informuar që Grupin për Studime Juridike dhe Politike, jemi dakorduar që në sesionin e ardhshëm të marrin një nismë së bashku, ta hartojmë një ligj të ri për konfliktin e interesit edhe pse përfaqësuesja e tyre është çakorduar me marrëveshjen, duke bërë një lobim në Komisionin e Integritetit. Sido që të jetë, lobimi është ligjor por ajo e ka thyer marrëveshjen që e kemi bërë në komision për të cilën, ju të gjithë keni qenë prezent kur jemi dakorduar për këtë çështje. Komisioni për Integritet dje e ka mbajtur mbledhjen dhe e ka aprovuar raportin me rekomandime nga komisioni ynë. Nëse ju jeni dakord, meqenëse ne e kemi votuar një herë, por nuk kemi ndërhyrje nga komisionet tjera të përhershme që ky raport të shkojë në seancën e radhës nëse mund të hyjë në rend dite.

Agim Aliu: Ishte pikërisht ashtu si deklaruar edhe ju në paraqitjen tuaj sa i përket këtij projektligji. Ne e kemi diskutuar dhe e kemi kaluar si grup punues edhe si komision për legjislacion. Kemi treguar edhe gatishmërinë që ndoshta do duhej të kishim bërë edhe më shumë ndryshime përmbajtësore për ti dhënë më shumë substancë këtij projektligji, por ka qenë pamundësia e kompetencës dhe e përgjegjësisë. Ne e kemi çmuar dhe vazhdojmë ta

çmojmë vullnetin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Në mbledhje kur kemi filluar ta shfletojmë këtë projektligj i kemi dhënë mundësinë edhe ndoshta jashtë kompetencës që përfaqësuesja e Grupit për Studime Juridike dhe Politike të referojë edhe një herë në komision, por ka qenë e pamundur të përfshihen ato. Ne nuk kemi hyrë në ndonjë analizë se çfarë mund të inkorporojë, por i kemi vlerësuar si adresime të drejta, mirëpo, në pamundësi për t'i futur që të bëhen pjesë e këtij projektligji. Përkundër që nuk kemi bërë shumë amendamente por ato janë shumë përmbajtjesore dhe esenciale për këtë projektligj të realizojmë një pjesë të qëllimit që ne i kemi vënë vetes. Në nismën e ardhshme të sesionit do të shohim mundësinë që edhe më shumë ta plotësojmë këtë substancë.

Komisionet e kanë shqyrtuar dhe i kanë rekomanduar po ashtu edhe ata Kuvendit që të miratojnë këtë projektligj. Debati më i gjerë është zhvilluar në Komisionin për Integritet pa ndonjë adresim të qartë e kanë përmendur që ky ligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Nuk janë adresuar sfidat e dala nga Raporti Progresit për vitin 2015, që ndërlidhen me parandalimin e konfliktit të interesit, mirëpo, ne jemi marrë vetëm me çështjen e plotësimit dhe ndryshimit sepse edhe ne kemi qenë të vetëdijshëm për këto sfida. Ka një zhvendosje teknike të amendamenteve që mos të viheni në lajthitje ju së pari anëtarët e komisionit, që nuk ka ndryshuar asgjë në esencë por vetëm në renditjen teknike.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, Kryesuesja konstatoi se komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e propozuara.

6. Të ndryshme.

Selvije Halimi, kryesuese, në fjalën e saj njoftoi për disa rekomandime të tri projektligjeve që janë dërguar në Komisionin Funkcional për zhvillim ekonomik, që nuk e di nëse janë takuar si komision, mirëpo, nuk kanë njoftuar se i kanë pranuar rekomandimet tona. Rekomandimet tona si do që të jenë, si të tilla dërgohen në seancë dhe në qoftë se hyjnë në rend dite në seancën e radhës, ne tha ajo, duhet të jemi të gatshëm t'i arsyetojmë.

Unë jam e gatshme ti bëj arsyetimet e atyre rekomandimeve që i kemi dërguar. Sot, me disa prej tyre bisedova dhe ju thash që problemin më të madh e keni aty ku keni zëvendësuar fjalën me “akt nënligjor” e keni kërkuar që të futet “statut” dhe ju keni privuar ministrinë përkatëse që të nxjerr udhëzime administrative, theksoi ne fund Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi